



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 25, dt. 10.06.2024

PËR  
TRANSFERIMIN E ASETVEVE TË PËRDORURA, NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË  
TEK SHKOLLA "AVDULLA ASABELLA"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77 i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrolin" i ndryshuar, udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me kërkesën e Ndërmarrjes së shërbimeve mbështetëse e arsimit e çerdhes, protokolluar me nr. 422, datë 03.06.2024, dhe me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e asetveve të përdorura (pesë sete kompjuterash; monitorë, desktop, maus, tastjerë, printera, tre skanera A4 dhe një projektör), të Këshillit të Qarkut Korçë, te shkolla "Avdulla Asabella" në fshatin Vinçan.
2. Të bëhen dalje nga magazina e Këshillit të Qarkut Korçë, asetet e përdorura (pesë sete kompjuterash; monitorë, desktop, maus, tastjerë, printera, tre skanera A4 dhe një projektör), sipas listës bashkëngjitur me sasinë dhe vlerat, më pas ti dorëzohen NSHMAÇ-së për të kaluar në pronësi të tyre shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës, zhvillimi ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të teritorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi



Miratuar me / 15 / Vota  
Vota Pro / 15 /  
Vota Kundër / 0 /  
Vota Abstenim / 0 /  
Zbardhur më datë / 10 / 06 / 2024

Konceptoi: R.Latollari

Konfirmoi: M.Bylykbashi

Prano: Sek.K.Q.B. Muç



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

PËR  
TRANSFERIMIN E ASETVEVE TË PËRDORURA (PESË SETE KOMPJUTERASH;  
MONITORË, DESKTOP, MAUS, TASTJERË, PRINTERA, TRE SKANERA A4 DHE  
NJË PROJEKTOR), TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut”, pika e, “Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe kërkesës të “Ndërmarrjes së shërbimeve mbështetëse e arsimit e çerdhes”, drejtuar Këshillit të Qarkut Korçë, regjistruar me nr. Prot. 422, datë 03.06.2024, për plotësimin e nevojave të shkollës Avdulla Asabella në fshatin Vinçan, me pesë sete kompjuterash; (monitorë, desktop, maus, tastjerë, printera), tre skanera dhe një projektor, ju propozojmë miratim e transferimit të aseteve të përdorura, nga Këshilli i Qarkut Korçë, te shkolla “Avdulla Asabella”. Në kërkesën e sjellë pranë Këshillit të Qarkut nga ana e Ndërmarrjes së shërbimeve mbështetëse e arsimit e çerdhes, është paraqitur nevoja që ka shkolla e sipërpermendur për kompjutera, me qëllim krijimin e një laboratorit informatik. Ky laborator do të lehtësojë punën e mësuesve të informatikës për një ecuri normale të procesit mësimor – edukativ dhe rritjen e efektivitetit të mësimdhënies. Duke parë se zyrat e institucionit të Këshillit të Qarkut Korçë janë të kompletuara me kompjutera dhe në magazinë gjenden edhe kompjutera të tjerë në gjendje pune, në gjykimin tonë nuk përbën problem transferimi i pesë seteve me kompjutera, printera, tre skanera dhe një projektor me llampë tek shkolla e fshatit Vinçan.

Bazuar në sa më sipër; i propozojmë Këshillit të Qarkut Korçë,

të miratojë P/Vendimin për transferimin e aseteve të përdorura (pesë sete kompjuterash; monitorë, desktop, maus, tastjerë, printera, tre skanera dhe një projektor), nga Këshilli i Qarkut Korçë tek shkolla “Avdulla Asabella” në fshatin Vinçan.

Korçë, më 03.06.2024

ZYRA E SHËRBIMEVE,  
BURIMEVE NJERËZORE  
DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Redin Latollari